URDHËR
Nr. 877, datë 25.6. 2021

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të germës "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.6.2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici, i delegohet kompetenca, për:

- nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësimin e Ministrisë së Mbrojtjes përpara gjykatave, në çështjet në të cilat Ministria e Mbrojtjes është palë;
- nënshkrimin e ankimeve, rekurseve, kërkesave për rishikim, kundërankimeve, kundërrekurseve, të cilat ushtrohen kundër vendimeve në të cilat Ministria e Mbrojtjes ka qenë palë ndërgjyqëse;
- nënshkrimin e padive, kundërpadive, kërkesave për sigurim padie, kërkesave për pezullim ekzekutim vendimi gjyqësor, të cilat ushtrohen nga Ministria e Mbrojtjes.

2. Të gjitha aktet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të urdhrit nr. 1905, datë 20.10.2017, të Ministrit të Mbrojtjes, "Për delegim kompetence", do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

3. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 1905, datë 20.10.2017, i ministrit të Mbrojtjes, "Për delegim kompetence", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi